



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0809

OSHP: 2023/0810

OSHP: 2023/0811

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërjen Vedat Poterqoi-Kryetar, Vjosa Gradinaj dhe Isa Hasani, Anëtar, duke vendosur lidhur me ankesat e operatorëve ekonomik [OE] “TSR SHPK”, “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK dhe “G.S.G SHPK” të parashtruara kundër Vendimit të datës 28.09.2023 për dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve” me numër prokurimi 214-22-12927-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme [MPB] në cilësinë e autoriteti kontraktues [AK], me 01.02.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohen si të bazuara, ankesa e OE “TSR SHPK” ushtruar me datë 18.10.2023 [Nr. 809/2023] dhe ankesa e OE “G.S.G SHPK” e ushtruar me datë 19.10.2023 [Nr. 811/2023], Anullohet Vendimi i datës 28.09.2023 për dhënie të kontratës i Ministrisë së Punëve të Brendshme në cilësinë e autoriteti kontraktues, kurse procesi i prokurimit publik “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve” numër 214-22-12927-1-1-1, kthehet në rivlerësim.

1.1. Urdhërohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore në emër dhe për llogari të ankuesve OE “TSR SHPK” dhe “G.S.G SHPK” të cilët në afat prej 60 /gjashtëdhjetë/ ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duhet të ushtrojnë kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

2. Refuzohetsie pa bazuar, ankesa e OE “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK, e ushtruar me datë 18.10.2023 [Nr. 810/2023] kundër vendimit të AK dhe lidhur me aktivitetin e prokurimit publik të precizuar si në paragrafin 1, të dispozitivit të këtij vendimi.

2.1. Konfiskohet shumat e mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore nga OE “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK të cilat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 28.09.2023, Ministria e Punëve të Brendshme [MBP], duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues, ka publikuar Vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit publik “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve” numër prokurimi 214-22-12927-1-1-1, sipas të cilit është rekomanduar për kontratë GOEEgo Elsa & Rade Koncar SHPK.

Me 18.10.2023, Operatori Ekonomik “TSR SHPK” në Prishtinë, ka parashtruar ankesë [numër protokoli 2023/0809] kundër Vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit, i përshkruar tani më si më sipër.

Me 18.10.2023, Operatori Ekonomik “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK, ka parashtruar ankesë [numër protokoli 2023/0810] po ashtu kundër Vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues.

Me 19.10.2023, edhe Operatori Ekonomik “G.S.G SHPK” po ashtu ka parashtruar ankesë [protokoli 2023/0811] kundër Vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues.

Në fazën e shqyrtimit paraprak,

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake siç kërkohet me nenin 108/A të këtij Ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar siç përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, dhe nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet e parapara me nenin 111, do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e kërkuara sipas dispozitave të cituara dhe bijën nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105 të LPP, lidhur me nenin 9 të Rregullores për Punën e OSHP. Duke ju referuar ankesave të parashtruara, përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në raport me aktivitetin e prokurimit dhe aktin e atakuar të autoritetit kontraktues, konstatohet se lidhur me çështjen në rastin konkret gjë zbatim neni 84 (Bashkimi i çështjeve administrative në një procedure) i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, lidhur me nenin 16 (Rastet e unifikuara) të Rregullores për Punën e OSHP, sipas të cilit ankesat të cilat në kuptimin e pretendimeve janë të lidhura me lëndën apo tenderin e njëjtë, mund të përfshihen në raportin e shqyrtimit fillestar nga i njëjti ekspert dhe ka të drejtë të vendos i njëjti Panel shqyrtues.

Bazuar në veprimet si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar, i cili:

- Me 01.11.2023, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit Nr. 809/2023, lidhur me pretendimet ankimore të OE “TSR SHPK”.
- Me 01.11.2023, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit Nr. 810/2023, lidhur me pretendimet ankimore të OE “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK.
- Me 14.11.2023, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit Nr. 811/2023, lidhur me pretendimet ankimore të OE “G.S.G SHPK”
- Konstatohet se të tri raportet e cituara në këtë rast, përmbajnë rekomandimin unik si në vijim:
- Ankesat të aprovohen si të bazuara pjesërisht, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës; aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim;

Raportet e ekspertizës i përmbajnë në parim elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe të njëjtat janë pranuar nga palët, sikurse kërkohet me nenin 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Megjithatë, të tri raportet e cituara përmbajnë në faqet e para formulime relativisht konfuze, sepse në ankesën e OE “TSR SHPK” shkruan se i njëjti ka ushtruar ankesë “kundër vendimit... ku është rekomanduar OE “TSR SHPK”; në ankesën e OE “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK, shkruan në kuptimin se ankuesi ka atakuar vendimit për dhënie të kontratës sipas të cilit është rekomanduar vet ai/ajo; në ankesën e ushtruar nga OE “G.S.G SHPK” figuron po ashtu i njëjti formulim dhe me të njëjtin kuptim. Më tej, krijohet konfuzion lidhur me atë se cili tip i kontratës është aplikuar dhe se cilit njoftim/vendim paraprak të OSHP i referohet përderisa citohen datat e po këtyre ankesave [shih: baza ligjore e arsyetimit]. Po ashtu në ekspertizat Nr. 810 dhe 811, faqe 2 deri 10 -14, përmbajtja tekstuale nuk është radhitur si duhet nga ana teknike dhe kjo pengon në leximin e tyre pa pengesë [shih: dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore]. Po ashtu konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me tërësinë e shkresave të kësaj lënde sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar andaj Paneli konsideron se ka kushte të vendos në mënyrë meritore. Në të vërtetë pjesë përbërëse e shkresave të kësaj lënde është dhe Raporti i Fakultetit Teknik të Prishtinës, i datës 26.07.2023, i kërkuar sipas Vendimit të këtij Organi PSH. Nr. 167,169,170,178/23, datë 13.06.2023, me të cilin disponojnë palët dhe përfshihet në aspekte të caktuara në kontekstin e pretendimeve të palëve.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli konstatoi paraprakisht senuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.75 të LPP, prandaj mori në shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka pasur nevojë të konvokohet seanca publike me palë në kuptim të paragrafit 2, të Rregullores së cituar, mbajtur me 28.12.2023, për vlerësimin objektiv të pretendimeve dhe në interes të një vendimi sa më të drejtë. Paneli në këtë rast analizoi pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve, ekspertizave e cituara dhe në përmbledhje,

konstatohet:

1. Ankuesi "TSR SHPK"

Sipas ankuesit, AK ka shkel nenin 1 të LPP sepse gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kërkesat e dosjes tenderit (DT) duke e rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm dhe me çmim më të lartë në shumën 171,575.36 €, duke vepruar njëherësh në kundërshtim me parimin e barazisë i sanksionuar me nenin 7, të këtij Ligji. AK ka shkelur dhe nenin 10 të LPP meqë sipas ankuesit, ka ofruar qasje të kufizuar në dokumentet e tenderit duke i klasifikuar si sekrete afariste raportet financiare, test raportet, certifikatat dhe ISO certifikatat, të cilat sipas tij/saj, kanë ndikim relevant në këtë aktivitet prokurimi, ndërsa kërkesa për sekret afarist nuk ishte plotësuar sipas nenit 11.3 të LPP dhe se ankuesi ka parashtruar dy herë kërkesë për qasje në dokumente. Sipas tij/saj, AK ka shkelur për rrjedhojë dhe nenin 11 të LPP, sepse i ka konsideruar informatat si sekrete pa u plotësuar kërkesat e paragrafit 3,4,5 të kësaj dispozite edhe pse vet AK e ka kërkuar deklaratën sipas kërkesave të këtij neni. Ankuesi ka pohuar se AK ka shkelur po ashtu nenin 59 të LPP pasi gjatë vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar kërkesat e paragrafit 4 të nenit 59 dhe kërkesat e DT, duke ju referuar në këtë rast mostrave të GOE të rekomanduar në kuptimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kërkesat e FDT [9.1&9.2/p.4, Aneksi 1]. Dhe, sipas ankuesit tabela/mostra e GOE të rekomanduar nuk posedon shiritat pikës 3 të FDT, 9.1&9.2, duke pohuar se Test Raporti nuk është në rregull dhe/ose në përputhje me kërkesën e AK. Meqë ky dokument nuk i është dhënë në shikim, ankuesi ka shprehur dyshimin se i njëjti nuk është dorëzuar apo posedon mangësi, duke pohuar në vijim se deklarata e GOE të rekomanduar duket të jetë e rrejshme sepse folia e paraqitur nga i njëjti, nuk është sipas kërkesave të AK dhe DT. Në këtë rast, ankuesi deklaroi se posedon një Test Raport të siguar nga një procedurë tjetër e prokurimit, duke theksuar “besojmë shumë se e njëjta është dorëzuar dhe te kjo procedurë” krahas deklaratimit “dyshojmë që nuk është testuar fare tabela 01-999-AD”. Meqë sipas tij/saj, ky raport [v.j. d.m.th. i një aktiviteti tjetër] është lëshuar nga Laboratori i akredituar DEKRA, ankuesi ka ofruar të dhëna kontaktuese të personit kompetent me kërkesë që eksperti të hulumtoj se çfarë ka testuar OE Rade Koncar, sepse ankuesi thekson se sipas bisedës me të njëjtin, mund të kuptohet se “nuk është testua targa e RKS siç pretendon AK”. Duke ju sërish kërkesave të DT, ankuesi ka pohuar se GOE i rekomanduar e ka dorëzuar mostrën me mangësi dhe/ose pa shirit duke theksuar “mbetemi të bindur se ajo nuk i plotëson kushtet e kërkuara ose mund të mungoj fare”. Ankuesi ka deklaruar se ky GOE ka dhe mangësi tjera lidhur me pikën 10, Aneksit 1, të DT me supozimin se nuk ka e plotësuar dhe kriterin “shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent”. Në test raportin e GOE të rekomanduar nuk shihen të dhënat për testimin e foljes së bardhë dhe të gjelbër reflektuese dhe të targës RKS, si kërkesa decidive të Aneksit 1, të cilat dëshmohen me Test Raport të prodhuesit, që sipas ankuesit GOE i rekomanduar, nuk e posedon ose nuk është i rregullt, duke propozuar që në seancën e shqyrtimit të sigurohet mostra dhe të krahasohen me kërkesat e DT. Bazuar shkurtimisht në pohimet si më sipër, ankuesi ka pohuar se këto veprime përbejnë shkelje të nenit 59 të LPP, duke pohuar më tej se ekzistojnë edhe mangësi tjera të cilat konstatohen nga raporti i forenzikës, të cilat shfaqin mospërputhje të mostrës në raport me kërkesat e DT.

[Raporti i ekspertit] Pohimet ankimore janë analizuar dhe prezantuar në mënyrë të përmbledhur në raportin e ekspertit, në të cilin pretendimet e ankuesit janë ndarë në a) pretendime ankimore lidhur me shkaqet dhe arsyet e eliminimit të tij/saj; dhe b) ato kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë, duke e specifikuar fakti se me çmim më të lartë se ankuesi. Në këtë rast, sipas raportit të ekspertit shqyrtues konstatohet se:

1. Sipas AK, Ankuesi nuk ka ofruar dëshmi në pajtim me kërkesat e DT, sepse raporti i testimit me rezultat pozitiv sipas standardit ISO 7591 për Alumin 1050 H42 ose EN AW 1200 H42; Dëshmitë nga “Novelis” janë konsideruar të pa-pranueshme me arsyetimin se i njëjti nuk është laborator ëshmitë shtesë paraqitur pas hapjes janë të papranueshme;

2. Nga pikëpamja e ekspertit shqyrtues, Raporti testues është në pajtim me standardin ISO 7591 ashtu siç është kërkuar nga AK, me arsyetimin se është dorëzuar dëshmia nga prodhuesi i shiritave të aluminit Novelis i cili e furnizon me alumin EN AW 1200 H42 dhe kompaninë EHA (anëtar i grupit të OE ankues). Fakti se në raport testues të mungon një detaj si në rastin konkret “EN AW 1200 H42” nuk nënkupton se produkti nuk e plotëson kriterin dhe/ose nuk përbehet nga ky material. Kurse, arsyetimi i AK se dëshmitë tjera me datë pas hapjes së ofertave, është i pabazuar pasi dokumentet dëshmi shtesë nuk kanë për qëllim zëvendësimin e dokumentit ekzistues, por sqarimin e të njëjtit dokument i cili ka ekzistuar. Lidhur me pohimin e ankuesit se të njëjtit i është dhënë qasje e kufizuar në dokumente të OE fitues, eksperti shqyrtues ka shprehur mendimin se ISO standardet dhe raportet e testimit kanë mundur të ofrohen ankuesit së paku në formë të spastruar. Bazuar në të lartcekurat, sipas ekspertit shqyrtues pohimet e ankuesit si më sipër, janë të bazuara.

2.1. Duke ju referuar pretendimeve të ankuesit kundrejt GOE të rekomanduar për kontratë, lidhur me faktin se mostrën e OE fitues shiritat nuk e kanë shkronjat RKS; b) se shkronja janë shtyp me Sito Shtypje; c) shkronjat RKS majtas mungojnë, eksperti ka deklaruar se nuk mund të ofroj përgjigje meqë çështjet si më sipër tejkalojnë kapacitetin e tij profesional, duke ju referuar analiza të Fakulteti Teknik të cilat sipas tij duhen marrë jo kontestuese.

2. Ankuesi “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK

Duke ju referuar nenit 3 dhe 3.1. të DT, ankuesi ka pohuar se AK ka bërë shkelje ligjore lidhur me mos vlerësimin e drejtë dhe objektiv të ofertës në pajtim të plotë me kërkesat e DT, duke shpjeguar se oferta e tij përmban, siç thuhet “argumente ligjore dhe teknike” të cilat nënkuptojnë dokumente të laboratorëve të akredituar dhe janë në pajtim me nenin 27 dhe 28 të LPP. Sipas ankuesit, vendimi i AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk ofron përgjigje lidhur me argumentet e ofruara, por përmban vetëm “kopje të arsyetimit” nga Letra për tenderuesin e eliminuar, andaj ankuesi deklaroi se i dorëzon sërish në cilësia të provave materiale në bashkëngjitje të kësaj ankese Testimet e laboratorit DEKRA Automobil GMBH, Informatat që DEKRA është laborator i certifikuar ndërkombëtarisht, përfshirë dhe Laboratorin KURZ i cili

bën testim të targave të prodhuara nga UTSCHE si pjesë e Konsorciumit, që tregojnë qarte që parametrat teknike të kërkuara nga AK për prodhimin dhe furnizimin me targa për regjistrim të automjeteve ofruar janë në pajtim të plotë me Aneksin 1, të specifikave teknike të detyrueshme, për të cilat AK ka mundur të bëjë verifikim të tyre. Mirëpo meqë sipas ankuesit, AK nuk e ka bërë verifikimin profesional të tyre, ka shkelur nenin 59, 69 dhe nenin 72 të LPP andaj për pasojë edhe procesi i vlerësimit të ofertave ka qenë subjektiv, jo ligjor dhe jo profesional. Ankuesi shpjegon më tej [pa nevojë për përshkrimin e tyre] se ka dorëzuar mostrën dhe sqarime lidhur me mostrën e dorëzuar dhe deklaratën për specifikat teknike, krahas shpjegimit se është e pamundur të prodhohet një mostër e vetme me të gjitha elementet e sigurisë. Megjithatë e ka ofruar mostrën sipas Aneksit 1, por pa masat e veçanta të sigurisë, sepse nuk ka qenë e obliguar dhe duke shpjeguar se askund në Evropë dhe gjetiu, nuk ekziston ndonjë Institut i posaçëm për stampim të shtresës së nxehtë, siç ka kërkuar AK, krahas shpjegimit se kërkesa e AK, që data e porosisë të jete e stampuar në anën e prapme të kërkesës specifike nuk parashihet të jetë si masë e veçantë e sigurisë, por duhet të jete në harmoni me specifikimin teknik të detyrueshëm të Aneksit 1. Bazuar në pohimet si më sipër, ankuesi ka theksuar se oferta e tij padrejtësisht është eliminuar nga raporti i forenzikës dhe komisioni për vlerësimin e ofertave, përderisa sipas tij, në faqe 15 të FTD, nuk kërkohen masa të veçantë të sigurisë por vetëm të merret parasysh kualiteti i materialeve sipas Aneksit 1. Nga ana tjetër, ankuesi pohon se komisioni për vlerësimin e ofertave, nuk e ka ekzaminuar ofertën sipas Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit. Andaj sipas tij, AK ka shkelur dhe nenin 1, 2, 6 dhe 7 të LPP duke e diskriminuar ankuesin përkundër faktit se ka ofruar me çmimin më të lirë prej 673,953.53 € në krahasim me GOE të rekomanduar.

[Raporti i ekspertit] Në raportin e ekspertit shqyrtues konstatohet se pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë kryesisht me shkaqet dhe arsyen e eliminimit të tij, i cili:

1. Sipas AK nuk e ka ofruar Test raportin në pajtim me ISO 7591, sipas kërkesave të DT, nuk e ka të evidentuar se është bërë testim për targat 01 999 AD dhe nuk është evidentuar Alumini EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42. Mostra nuk mban datën e porosisë, shiritat me ngjyrë të zezë nuk mbajnë shenjën RKS të përsëritur periodikisht.

2. Lidhur me këtë, eksperti shqyrtues ka shpjeguar se ankuesi e ka ofruar test raport nga Dekra në pajtim me ISO 7591, mirëpo nuk ka informata çfarë targe është testuar dhe për ku është e dedikuar. Lidhur me këtë ekspertit ka shprehur mendimin se: AK ka mundur të kërkojë sqarime nga Eric UTSCHE, anëtar i grupit dhe nga laboratorit testues. Dhe se, mungesa e evidentimit Alumini EN AW 1050 ose 1200 H42 nuk nënkupton automatikisht se targa nuk e punuar nga materiali i lartcekur. Kurse për sa i takon datën, sipas raportit të fakultetit, mostra 666 mban datën e porosisë. Ndërsa sa i përket arsyes se mungon shenja RKS në mënyrë të përsëritur në shiritat e zi, kjo nuk mund të përdoret si arsye e eliminimit. pasi përmes dosjes është përcaktuar se “*Mostra nuk është e obligueshme që të kenë masat e veçanta të sigurisë...*”.

Bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, eksperti ka konsideruar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara duke pas parasysh se OE është dukshëm me çmim të ulët në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë.

3. Ankuesi "G.S.G SHPK"

Në hyrje një varg pohimesh të ankuesit, i janë adresuar Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, i cili sipas ankuesit, ka marre vendim për dhënie të kontratës në kundërshtim flagrant me dispozitat e nenit 56,59,60 të LPP, lidhur me dispozitat e nenit 39,40,45 të Rregullores për Prokurim Publik [Nr.001/2022] duke i vlerësuar personalisht ofertat dhe duke nxjerr vendim arbitrar për ta shpallur fitues një OE për të cilin është e faktuar se është i papërgjegjshëm dhe me i shtrenjtë mbi 200,000.00 €, në krahasim me ofertën e ankuesit. Duke deklaruar më tej, se me asnjë dispozitë të LPP dhe Rregullores së cituar nuk parashihet një kompetencë e tillë për zyrtarin përgjegjës të prokurimit i cili ka statusin e anëtarit në komisionin vlerësues, andaj sipas ankuesit kjo përbën vepër penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, që t'i sjell përfitim të paligjshëm një OE i cili është i papërgjegjshëm duke e cituar në këtë rast shumën 200,000.00 €. Ankuesi ka deklaruar se GOE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, sepse sipas Raportit të Forenzikes me Nr. Ref: AKF/2023-028 dt. 28.02.2023 (pika 3, faqe14 nga 40) është konstatuar se mostra/targa e evidentuar me shifrën nr.444 nuk e përmbush kërkesën e DT lidhur me Fijen Virtuale, kurse AK në kundërshtim me Raportin e Forenzikës dhe dispozitat e LPP ka vendosur dhe/ose konstatuar se GOE e përmbushë kërkesën e DT në raport me fijen virtuale. Sipas ankuesit edhe gjate fazës së pare të vlerësimit, mangësitë e konstatuara për GOE Ego Elsa & Rade Koncar, janë fshehur nga komisioni vlerësues paraprak dhe/ose zyrtari përgjegjës i prokurimit i cili nuk ka arsyetuar pse nuk ka marrë parasysh konstatimet nga Raporti i Forenzikës.

Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK dhe në kontekstin e kriterëve të paraparë me DT duke shpjeguar se, sipas AK nuk i kemi përmbushur kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale nga pika 2, përkritazi me mostrën, për çfarë ankuesi ka shpjeguar se nuk është detyruese ti këtë masat e veçanta të sigurisë, por të jenë në harmoni me kualitetin e materialeve sipas specifikave teknike të dhëna në Aneksin 1, dhe se mostra e dorëzuar nga ana e tij është në harmoni me Aneksin 1. Sipas ankuesit, pretendimi i AK se mostra e dorëzuar duhet të jete 01-999-AD e jo 01-444-AD, është përtej logjikës sepse nuk prodhohet në mënyrë specifike vetëm targa 01-999-AD, përderisa prodhimi behet për gjitha kombinimet, shkronjat, gërmat sipas dizajnit dhe prandaj në aktivitete paraprake nuk ka pasur një pretendim të tillë, por janë dorëzuar mostra të ndryshme. Sipas ankuesit është i paqëndrueshëm pretendimi i AK se kinse fija virtuale nuk është sipas kërkesës së DT, përderisa sipas raportit të forenzikes është konstatuar rregullsia e fijos virtuale, ndërsa sa i përket Raportit të Fakultetit Teknik ka shprehur opinionin se të njëjtit nuk kanë fare pajisje për të shikuar fijen virtuale apo të bëjnë matjen dhe analizën e saj. Sidoqoftë, sipas ankuesit kur dy ekspertiza ose raporte janë kontradiktore behet matja në një laborator të tretë, duke ju referuar nga ky kontekst vendimit të OSHP Nr. 2023/0167, sipas të cilit ky Organ "...vendosi që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në ri-vlerësim dhe obligon AK që këto mostra të dërgoj në ndonjë laborator apo fakultet teknik, me kërkesë që matja e këtyre mostrave të bëhet sipas kërkesës së DT, d.t.th materiali baze i mostrës". Kurse veprimi i AK [sipas ankuesit] është në kundërshtim me vendimin e OSHP dhe matjet e bëra nga Agjencia e Forenzikes e cila ka konstatuar se mostra/targa me shifrën Nr. 444, e OE Ego Elsa & Rade

Koncar nuk e përmbush kërkesën e DT ne raport me fijen virtuale. OSHP është perkujdesur për ketë dhe ka dhënë sqarim se çka duhet të dërgoj AK për matje duke e theksuar qartë “d.m.th materiali baze i mostrës” kurse AK qëllimisht i ka dërguar për matje të gjitha përmasat për të ndryshuar rezultatet paraprake të matjeve të bëra nga Agjencia e Forenzikës, që t’i mundësohet kundërligjshëm OE të rekomanduar të jetë fitues i këtij aktiviteti të prokurimit. Ankuesi ka shpjeguar po ashtu, se sipas vendimit të AK nuk kemi përmbushur kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe Profesionale, pika 3, lidhur me Test Raportin nga Laboratori apo instituti i autorizuar duke shpjeguar në këtë rast se ka dorëzuar Test Raportin 1140-2/1894783071/20, datë 22.09.2020, nga DEKRA Automobile GmbH, laborator i akredituar për testime dhe certifikime për standardin ISO 7591, në të cilin është e shkruar qarte se mostra është testuar konform pikave [v.j. pa nevojë të përshkruhen] të Standardit ISO 7591:1982 duke shpjeguar më tej se është i pajisur me certifikatë sipas së cilës konfirmohet se mostra e ankuesit i përmbushë gjitha kërkesat e standardit të cituar duke e prezantuar në vijim përgjigjen e këtij entiteti [si informatë plotësuese]. Në vijim ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të AK, me pohimin se sipas tij/saj GOE të rekomanduar është i papërgjegjshëm, sepse i njëjti nuk ka përmbushur kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe Profesionale, pika 2, sepse mostra e dorëzuar nuk posedon shenjen RKS te numrat dhe shkronjat dhe datën e porosisë dhe nuk ka dorëzuar Sigurimin e Tenderit konform LPP, por e ka dorëzuar nga një institucion jo i licencuar nga BQK, në është në kundërshtim me nenin 28.5 te Rregullores së cituar, me nenin 5 të Ligjit për sigurimet. Në vijim, ankuesi ka deklaruar se edhe OE tjerë nuk i kanë përmbushur kërkesat e DT, mirëpo Paneli konsideron se nuk ka nevojë të citohen emrat dhe/ose pohimet e ankuesit, meqë të njëjtit nuk janë palë ankimore në këtë proces prokurimi.

[Raporti i ekspertit] Siç thuhet në raportin e ekspertizës, ankuesi ka ngritur një serë pretendimesh ankimore, të cilat edhe në këtë rast janë ndarë nga eksperti në dy grupe: a) pretendimet ankimore mbi arsyet e eliminimit të tij; b) pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë. Edhe në këtë rast, eksperti e ka theksuar faktin se GOE I rekomanduar për kontratë është me çmim më të lartë se ankuesi. Sidoqoftë, sipas këtij raporti konstatohet s: arsyet e AK-së për eliminimin e ankuesit kanë të bëjnë me atë se i njëjti:

1. Sipas AK, ankuesi ka ofruar Raport të testimi nga DEKRA për ISO 7591, ndërsa lidhur me kërkesën për stampim të nxehtë ka ofruar Raport nga ZAG, i cili raport thirret në raport të testimi nga viti 2018. Mostra e ofruar mban numrat 01 444 AD, e jo 01 999 AD. Kurse, Fija virtuale është më e madhe se ajo e lejuar në dosje të tenderit.

2. Sipas ekspertit, në DT lidhur me specifikat teknike është kërkuar stampimi i nxehtë, mirëpo dokumenti i kërkuar ka qenë “certifikata dhe test raporti i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardet ISO 7591, i lëshuar nga një laborator i akredituar”. Pras siç shihet nga DT lidhur me “dokumentin e kërkuar” është kërkuar vetëm raporti i testimi në pajtim me standardet ISO 7591, i lëshuar nga një laborator i akredituar.

- Kurse, sa i përket fijes virtuale, sipas FDT pika 9.1&9.2 thuhet, “Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë” andaj vija virtuale si masë e sigurisë, nuk mund të përdoret si shkak për eliminimin e ankuesit.

- Sa i përket arsyetimit të AK, se mostra mbart numrin 01 444, e jo 01 999, eksperti ka shpjeguar se kërkesë e DT ka qenë, cituar "dorëzojnë një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim" andaj konsideron se mostra e ankuesit është në pajtim me kërkesat DT
- Sa i përket faktit se mostra e ofruar nuk ka shenjë RKS dhe nuk ka datë, eksperti shqyrtues ka deklaruar se nuk ka kapacitet teknik dhe/ose profesional për të trajtuar këtë pretendim ankimor dhe sipas tij duhet mbështetur në Raportet e testimit nga Fakulteti.
- Kurse për sa i përket fakti se fija virtuale sipas raportit të forenzikës është jashtë parametrave të kërkuar me DT, eksperti sqaron se me vendim të OSHP pas raportit të forenzikës, AK është obliguar të dërgoj mostrat prapë për testim.
- Sa i përket pretendimeve ankimor kundrejt OE të tjerë të cilët po ashtu janë eliminuar nga AK, konstatohet se të njëjtit nuk kanë parashtruar ankesë në OSHP.

Lidhur me raportin e ekspertizës Nr. 2023/0811, pala ankuese ka shprehur mendimin e tij ndaj raportit të ekspertizës por edhe në seancën e mbajtur me palë të datës 28.12.2023 duke deklaruar paknaqësin e tij lidhur me mos shqyrtimin e pretendimeve ankimore nga ana e ekspertit shqyrtues. Lidhur me këtë në seancën e mbajtur është dakorduar se eksperti shqyrtues të bëjë edhe një plotësim të kësaj ekspertize duke u përgjigjur në pretendimet ankimore. Me datën 18.01.2024, eksperti shqyrtues bënë plotësimin e raportit të ekspertizës 2023/0811. Si në vijim:

Sqarim Hyrës : me rastin e mbajtjes se seancës per shqyrtim kryesor per ankesen nr.811/23, jemi informuar nga OE : "GSG" se ne raportin e ekspertizes nr.811/23 nuk I kemi shqyrtuar te gjitha pretendimet ankimore te parashtruara nga OE ankues ne ankesën e tij. Gjatë seancës përfaqësuesi I OE : "G.S.G" pretendon se eksperti shqyrtues nuk i ka trajtuar sias pretendime ankimore e më konkretisht pretendimin e tij ankimorë sa I përket sigurimit të tenderit të OE : "Erich & Horn Kosova".

Fillimisht duhet pohojmë se pretendimi I OE është I vërtetëm në kuptimin e asaj se me rastin e dorëzimit të raportit të ekspertizës nr.811/23 nuk e kemi trajtuar këtë pretendim ankimorë. Dëshirojmë të cekim se në ditën kur kemi dorëzuar/procesuar raportin e ekspertit për ankesën nr.811/23, po të njëjtën ditë kam pas te paraqitem pranë QKUK , për të ju nënshtuar një intervenim kirurgjik, për këtë arsye jam ngutur gjatë procesimin e raportit. Si do që të jetë, në vazhdim po japim përgjigjen tonë në pretendimin ankimorë të OE : "G.S.G" lidhur me Sigurimin e tenderit të ofruar nga OE "Erich Utsch AG; Horn & CO. Kosova SHPK".

OE: "G.S.G" ndër të tjera pretendon se OE Erich Utsch AG; Horn & CO. Kosova SHPK": "nuk kane dorëzuar Sigurimin e Tenderit konform LPP-se sepse ka dorëzuar nje sigurim nga nje institucion i cili nuk eshte i licencuar nga BQK-ja dhe eshte ne kundërshtim me Nenin 28.5 te Rregullores Nr.001/2022 per Prokurim Publik dhe ne kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L045 per Sigurimet neni 5."

Pas analizimit të ofertës së OE Erich Utsch AG; Horn & CO. Kosova SHPK", kemi gjetur se i njëjti OE ka bashkangjitur një dëshmi nga "Commerzbank" në emër të garancisë/sigurimit të tenderit. Provë: garancioni me kërkesë të parë nga Commerzbank. Konform nenit 28.5 të rregullave për prokurim publik 001/2022 sigurimi i tenderit : "Sigurimi i tenderit mund të dorëzohet në njërën nga format e përcaktuara në Nenin 57, paragrafi 5, të LPP-së në përputhje me Ligjin për Sigurimet.". Ligji për Sigurimet në Republikën e Kosovës Nr. 05/L -045, neni 5 (Ndalesat dhe Përjashtimet), par.1 dhe në veçanti par.4 i

këtij neni decidivisht e ndalon/përrjashton mundësinë që një sigurues i cili nuk është i licencuar nga BQK të bëjë marrë në sigurim të drejtpërdrejt një rrezik që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës pa u licencuar nga BQK-ja. Citat i neni 5 par.4 të ligjit per sigurime Nr. 05/L -045: 4. Siguruesi i një vendi të jashtëm nuk lejohet të ofrojë dhe të marrë në sigurim të drejtpërdrejtë një rrezik, që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie, që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa u licencuar nga BQK-ja. Ne më tutje kemi shkarkuar listën e institucioneve financiare të licencuara/regjistruara pranë Bankës Qendrore të Kosovës, dhe pas analizimit të kësaj liste, kemi gjetur se nuk figuron emri i “Commerzbank” nuk është institucion financiar i licencuar/regjistruar pranë BQK-së.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se sigurimi i tenderit i ofruar nga OE: ” Erich Utsch AG; Horn & CO. Kosova SHPK” është në kundërshtim me dispozitat e nenit 28.5 të rregullores 001/2022 për prokurim publik si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 par.1 dhe par.4 të Ligjit për sigurime, pasi është lëshuar nga një sigurues i cili nuk është i licencuar/regjistruar si institucion financiar pranë BQK-së dhe si i tillë është i pavlefshëm.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli analizoi të gjitha pohimet ankimore, të secilit ankues, aktet dhe veprimet e palëve, raportet e ekspertizave duke konstatuar paraprakisht se AK ka zbatuar *procedurë të hapur*, përkufizuar me paragrafin 1.37 të nenit 4; *lloji i kontratës* furnizim, sipas paragrafit 1.45, të nenit 4; *vlera e parashikuar*: 2,632,297.70 €, sikurse parashihet mes tjerash me nenin 16 të LPP. Duke vepruar në kuptim të nenit 59, lidhur me nenin 60 të LPP, AK ka vendosur që me vendimin, tani i atakuar, OE “Ego Elsa & Rade Koncar” të rekomandohet si palë potenciale për kontratë, përderisa ankuesit kanë atakuar vendimin e AK, në parim që të gjithë për të njëjtat shkaqe dhe arsye dhe apriori mbi të njëjtën bazë. Krahas kësaj Paneli vëren se raportet e ekspertit shqyrtues përmbajnë rekomandime unike, krahas konstatimit se oferta e OE të rekomanduar për kontratë është me çmim më të lartë në krahasim me tri ofertat e ankuesve. Nga ana tjetër, ë vështrim të ankesave vërehet se dispozitat e nenit 1, 59, 60, 69, të LPP janë përdorur si bazë ankimore në tri ankesat.

Sidoqoftë, të gjitha këto pretendime janë përfshirë në procesin shqyrtimit dhe vendosjes nga ana e këtij Paneli, me synimin e një vendosje sa më të drejtë dhe objektive. Megjithatë, në zbatim të kompetencave të parapara me nenet 98, 99, posaçërisht ato të parapara shprehimisht me nenin 105 të LPP, OSHP respektivisht Paneli Shqyrtues, udhëhiqet gjithnjë me pavarësinë e plotë të gjykimit pavarësisht natyrës komplekse të ndonjë prokurimi publik, për ti promovuar synimet bazë të LPP në kuptim të nenit 1, të LPP. Nga ana tjetër, OSHP është e detyruar që ti zbatoj parimet e parapara me nenin 7, lidhur me paragrafin 3, të nenit 104 të LPP, me synimin që të respektohet barazia e palëve. Në këtë rast, duke i analizuar të gjitha faktet dhe provat në dispozicion të shkresave të kësaj lënde, Paneli detyrohet ti marri në konsideratë faktet si në vijim:

Vendimi i atakuar në këtë rast i AK është marrë apo jo në harmoni me LPP. Sipas nenit 24 të këtij ligji, thuhet se “Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë përgjegjësi të autoritetit përkatës kontraktues pavarësisht nga shpërndarja e detyrave brenda autoritetit kontraktues sipas Nenit 22 të këtij ligji”. Kjo d.t.th. se shpërndarja e detyrave bëhet brenda autoriteti publik në referim të

nenit 22. Kurse, sipas nenit 22, Zyrtari Kryesor Administrativ, i cili [neni 4/1.6] nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm, Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin e tjerë, i cili e cakton zyrtarin përgjegjës të prokurimit [neni 23]. Kurse, aktiviteti i prokurimit nënkupton një proces administrativ, për çfarë organi publik në një procedurë administrative vepron nëpërmjet zyrtarit përgjegjës, siç thuhet në nenin 26, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative. Meqë në këtë rast ky aktivitet është akoma në rrjedhë e sipër, dhe pas ri-vlerësimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit ka dhënë një rekomandim të cilin nuk e ka pranuar Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (ZPP), dhe rekomandimi vetanak për kontratë i një OE pa një vlerësim apo formim të një komisioni tjetër të vlerësimit, Paneli konsideron se Zyrtari Përgjegjës të Prokurimit nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për prokurim publik, konkretisht nenit 39.11 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, për këtë ka edhe interpretim të KRPP i cili është i publikuar tek platforma e e-prokurimit i radhitur me Nr. 32, i cili citon: "Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit mund të: 1. pranojë rekomandimin e Komisionit vlerësues; apo 2. refuzojë rekomandimin e komisionit vlerësues. 1. Në rast se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e pranon rekomandimin e komisionit të vlerësimit, të njëjtin e aprovon (nënshkruan) dhe nxjerrë vendimin përfundimtar mbi dhënien e kontratës. 2. Në rast se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit e refuzon rekomandimin e komisionit të vlerësimit, do të shpjegojë arsyet me shkrim dhe menjëherë do të informojë me shkrim Zyrtarin Kryesor Administrativ të AK-së për këtë refuzim, si dhe të formoj komision të ri për ri-vlerësim". Kështu që, parimisht kjo paraqet një rëndësi ndërsa arsyet kryesore se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në ri-shqyrtim.

A është zbatuar nga AK, Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit PSH. Nr. 167,169,170,178/23, i datës 13.06.2023, sipas rekomandimeve të dhëna në këtë vendim ka qenë çështja kryesore dhe kontestuese matja e materialit bazë, të cilën Agjencioni i Forenzikës matjen nuk e ka bërë vetëm për materialin bazë ashtu siç ka qenë e përcaktuar në DT, por matjen e ka bërë si të tërësishme me ngjyra, dhe materiale tjera transparente, gjë që e kanë pranuar edhe përfqësuesit e Agjencionit të Forenzikës në seancën e mbajtur me palë. Ndërsa, matjet tjera të Agjencioni të Forenzikës, nuk janë konstestuar asnjëherë nga ana e Paneli Shqyrtues, dhe në vendimin e lartëcekur shprehimisht është kërkuar, citat "*Si rezultat i mos matjes së mostrave konform kërkesës së Dosjes së Tenderit, PSH vendosi që këtë aktivitet ta kthejë në ri-vlerësim, dhe obligon AK që këto mostra ti dërgoj në ndonjë laborator apo në fakultet të teknikës, me kërkesë që matja e këtyre mostrave të bëhet sipas kërkesës së DT që d.t.th. materiali bazë i mostrës*".

Më tej, duke ju referuar pohimeve ankimore e duke i analizuar ato dhe në kontekstin e raportit të ekspertit shqyrtues, konstatohet se:

I. Sipas AK: 1) **Raporti i testimi** i dorëzuar nga *Ankuesi "TSR SHPK"[809]* nuk është sipas standardit ISO 7591 për Alumin 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, kurse dëshmitë nga "Novelis" janë të pa-pranueshme sepse **nuk është** laborator por është prodhues; Dhe 2) dëshmitë shtesë paraqitur pas hapjes së ofertave janë të papranueshme. Sipas ekspertit Raporti testues është në pajtim me standardin ISO 7591, meqë prodhuesi i shiritave të aluminit Novelis **furnizon** me alumin EN AW 1200 H42 dhe kompaninë EHA (anëtar i grupit të OE ankues). Nëse në Raport testues të mungon një detaj si në rastin konkret EN AW 1200 H42 **nuk nënkupton** se produkti nuk e plotëson kriterin dhe/ose nuk përbehet nga ky **material**. Ndërsa dëshmitë shtesë të paraqitura pas hapjes së ofertave, nuk kanë për qëllim zëvendësimin e një dokumenti por sqarimin e të njëjtit i cili tani më ka ekzistuar. Sipas ekspertit ankuesi ka të drejtë lidhur me pohimin e tij për **qasje të kufizuar** në dokumentet e GOE fitues, pasi ISO standardet dhe raportet e testimi kanë mundur ti ofrohen ankuesit së paku në formë të spastruar sipas dispozitave të LPP. Andaj sipas ekspertit shqyrtues pohimet e ankuesit si më sipër, **janë të bazuara**.

Sa i përket Raportit të testimit i GOE të rekomanduar ekspertit ka deklaruar se është në pajtim me kërkesa e DT. Kurse nuk ka dhënë ndonjë konstatim lidhur me: 1) pohimin e ankuesit se mostrat e OE fitues, nuk i kanë shkronjat RKS, janë shtyp me Sito Shtypje, shkronja RKS majtas mungojnë, në mungesë të kapacitet teknik dhe/ose profesional duke ju referuar faktit se analizat e Fakulteti teknik konsiderohen kontestuese; 2) pohimin e ankuesit se AK ka ndërruar dëshmitë me rastin e dërgimit të mostrave nga Agjencia e forenzikës në Fakultet Teknik dhe përbën vepër penale, pasi sipas ekspertit kjo është çështje e organeve kompetente; 3) pohimin e ankuesit se GOE fitues ka kërkuar furnizim me targa po për këtë aktivitet të prokurimit, nga GOE anëtar i të cilit është ankuesi, nuk ka kapacitet teknik/profesional për prodhimin e këtyre targave, ankuesi ka ofruar korrespondencën [e-mailit] mes kompanive në fjalë në cilësi prove, bashkëngjitur me ankesë.

Paneli konsideron se AK ka të drejtë në konstatimin e tij/saj se Raporti i testimit i dorëzuar nga ankuesi nuk është sipas standardit ISO 7591 për Alumin 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, së paku për dy arsye: a) produkti i prodhuesi në rastin konkret supozohet padyshim se është paraprakisht i testuar dhe certifikuar për ti krijuar kushtet për plasman të artikullit: Alumin 1050 H42 ose EN AW 1200 H42; b) nëse testimi dhe certifikimi testimi i Aluminit 1050 H42 ose EN AW 1200 H42 sipas standardit ISO 7591 është detyrë e një laboratorit, ky test nuk mund të zëvendësohet me faktin se prodhuesi është furnizues me po këtë material. Andaj sado të jetë me vend mendimi i ekspertit se nëse në Raport testues të mungon një detaj si në rastin konkret EN AW 1200 H42 nuk nënkupton se produkti nuk e plotëson kriterin dhe/ose nuk përbehet nga ky material, megjithatë konsiston në një supozim, kurse shprehja “nuk do të thotë” nuk ka karakter prove, përderisa në procesin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve AK detyrohet të vendos apriori sipas fakteve të vërtetuara me prova jo kontestuese, duke kërkuar sqarim të mëtutjeshëm nga Ankuesi. Paneli në këtë rast veçon dy faktet në vijim: a) konstatimi i ekspertit se Raporti i testimit i GOE të rekomanduar është në pajtim me DT. b) dhe pajtohet me pohimin e ankuesit dhe konstatimin e ekspertit se AK e ka pasur për detyrë ta prezantoj versionin e spastruar në kuptim të paragrafit 4, të nenit 11 të LPP;

Dhe mbi bazën e gjitha këtyre analizave, rezulton se Ankesa duhet konsideruar e bazuar pjesërisht.

II. Sipas AK, se *Ankuesi “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK* nuk ka ofruar: 1) Test raport në pajtim me ISO 7591, sipas kërkesave të DT; 2) nuk e ka të evidentuar se është bërë testim për targat 01 999 AD; 3) nuk është evidentuar nëse është Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, ekspertit nuk ka ofruar ndonjë konstatim por ka dhënë mendimin se AK ka mund të kërkoj sqarime nga Eric UTSCHE, anëtar i grupit dhe/ose nga laboratorit testues. Kurse edhe në këtë ekspertit ka dhënë mendimin e tij se cituar “Mungesa e evidentimit Alumin EN AW 1050 ose 1200 H42, nuk nënkupton automatikisht se targa nuk është e punuar nga materiali i lartcekur”.

Sipas AK, mostra e OE nuk mban datën e porosisë, kurse sipas raportit të ekspertit shqyrtues është konstatuar se në bazë të raportit të Fakultetit mostra 666 **mban datën e porosisë**. 3. Sipas AK, shiritat me ngjyrë të zezë nuk mbajnë shenjën RKS të përsëritur periodikisht. Kurse sipas ekspertit kjo nuk mund të përdoret si arsye e eliminimit të Ankuesit, pasi sipas DT është

përcaktuar “Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë..”

Paneli konsideron se vërtetë oferta e ankuesit në këtë rast përmban të meta, për të cilat AK ka mund të kërkoj sqarime apo informata plotësuese nga ankuesi nëse test raporti i dorëzuar nga Ankuesi nëse do ishin plotësuar së paku dy kërkesat tjera në vijim, nëse i njëjti nuk e përmban raportin testim për targat 01 999 AD dhe nuk është evidentuar nëse është Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42. Mirëpo sipas të gjeturave të ekspertit shqyrtues se pas analizimit të ofertës së OE Erich Utsch AG; Horn & CO. Kosova SHPK”, kemi gjetur se i njëjti OE ka bashkangjitur një dëshmi nga “Commerzbank” në emër të garancisë/sigurimit të tenderit. Provë: garancioni me kërkesë të parë nga Commerzbank. Konform nenit 28.5 të rregullave për prokurim publik 001/2022 sigurimi i tenderit : “Sigurimi i tenderit mund të dorëzohet në njërën nga format e përcaktuara në Nenin 57, paragrafi 5, të LPP-së në përputhje me Ligjin për Sigurimet.”. Ligji për Sigurimet në Republikën e Kosovës Nr. 05/L -045, neni 5 (Ndalesat dhe Përjashtimet), par.1 dhe në veçanti par.4 i këtij neni decidivisht e ndalon/përjashton mundësinë që një sigures i cili nuk është i licencuar nga BQK të bëjë marrë në sigurim të drejtpërdrejt një rrezik që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës pa u licencuar nga BQK-ja. Citat i neni 5 par.4 të ligjit për sigurime Nr. 05/L -045: 4. Siguresi i një vendi të jashtëm nuk lejohet të ofrojë dhe të marrë në sigurim të drejtpërdrejtë një rrezik, që i përket një personi, një sendi ose një përgjegjësie, që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa u licencuar nga BQK-ja. Eksperti më tutje kemi shkarkuar listën e institucioneve financiare të licencuara/regjistruara pranë Bankës Qendrore të Kosovës, dhe pas analizimit të kësaj liste, kemi gjetur se nuk figuron emri i “Commerzbank” nuk është institucion financiar i licencuar/regjistruar pranë BQK-së. Atëherë, Paneli Shqyrtues konform dispozitave ligjore nuk ka si mos ta trajtoj ndryshe, përveç se si ofertë e papërgjegjshme për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Paneli vëren se Raport të testimin nga DEKRA për ISO 7591, i ofruar nga Ankuesi “G.S.G SHPK” [811] nuk është kontestuar si i tillë nga ana e AK. Andaj konstatimi i AK, se “ndërsa lidhur me kërkesën për stampim të nxehtë ka ofruar Raport nga ZAG, i cili i referohet një raportit të tillë të vitit 2018” nuk duhet venë në kontekstin që ta mohoj edhe vlerën e Raportit Testues. Eksperti ka pasur të drejtë në shpjegimin se në DT nuk shënon se certifikata dhe raporti testimin duhet të kenë të dhëna për “stampim të nxehtë”. Po ashtu nuk mohohet fakti se “...nga Dekra Automobile GMBH është konfirmuar se test raporti 1140-2/1894783071/20 konfirmon gjithashtu përputhshmërinë e shtresës me stampim të nxehtë sipas pikës 10 të Aneksit 1”. Andaj Paneli konsideron se eksperti ka të drejtë se raportet e cituara konsiderohen dokumente të rregullta.

Sipas AK, mostra mban numrin 01 444, e jo 01 999. Kurse sipas ekspertit shqyrtues, shpjegohet se sipas DT është kërkuar “*dorëzohet një mostër të targës së rëndomtë e cila është në përdorim*” andaj konsideron se mostra është në pajtim me DT, për çfarë pajtohet edhe Paneli. Mirëpo lidhur me pohimin e AK se mostra nuk ka shenjë RKS dhe datë, eksperti ka deklaruar se nuk ka kapacitet teknik dhe/ose profesional për të trajtuar këtë pretendim ankimor dhe se duhet mbështetur në Raportet e testimin nga Fakulteti. Nga ana e Panelit kjo nuk konsiderohet e mjaftueshme në kontekstin e ekspertizës, sepse fakte të tilla vërtetohen edhe përmes vrojtimit. Sidoqoftë duke ju referuar Raportit të cituar konstatohet se mostra ka shenjë dhe datë.

Sipas AK, Fija virtuale është më e madhe se ajo e lejuar në DT. Kurse sipas ekspertit shqyrtues në FDT, pika 9.1&9.2 thuhet se “Mostra nuk është e obligueshme që ti kenë masat e veçanta të sigurisë” andaj sipas tij, kjo nuk mund të përdoret sipas ekspertit si shkak për eliminimin e ankuesit, ku dhe në këtë pikë pajtohet edhe Paneli.

Sa i përket pohimit të AK se fija virtuale nuk është konform parametrave të kërkuar me DT, eksperti sqaron se sipas vendimit të OSHP, AK është obliguar të dërgoj mostrat prapë për testim dhe se Raporti i forenzikës tani është nulë (i pavlefshëm). Paneli shpjegon se Raporti i Forenzikës ka konstatuar rregullësinë e fijës virtuale, raport ky, i cili vazhdon të jetë dokument i pa kontestuar i shkresave të kësaj lënde përveç pjesës kontestues të cituar si më sipër, të cilën e kanë pranuar edhe vetë përfaqësuesit e këtij Agjencioni dhe si i tillë është akt i një autoriteti kompetentë të administratës shtetërore andaj asnjëherë nuk është konsideruar nulë nga ana e panelit dhe nuk shpallet nulë asnjë dokument i asnjë autoriteti shtetëror dhe/ose publik, vetëm me deklarinimin e një anshëm të asnjë eksperti. Bazuar nga ato si më sipër, Paneli konsideron se ankesa është e bazuar.

- Përfundim -

Duke e analizuar Vendimin e atakuar të AK në raport me opinionin e ekspertit shqyrtues, ndonëse i njëjti nuk mbisundon mbi kompetencat ligjore të parapara me nenet 98, 99 dhe 105 si kompetenca ekskluzive të Organ dhe ndonëse nuk krijon efekte detyrues për Panelet Shqyrtuese të cilat ushtrojnë pavarësinë e plotë në zbatimin e kompetencave sipas nenit 105 të LPP, megjithatë çdo raport i tillë, në çdo rast analizohet në kontekstin e vlerësimit, krahasimit dhe administrimit me të gjitha provat dhe i njihet vlera provuese në kontekstin e përgjithshëm të vendimmarrjes. Nga ana tjetër, në çdo rast Paneli ka parasysh dhe paragrafin 4, të nenit 104, sipas të cilit OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale në raport me shkeljen e pretenduar duke marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave dhe interesat që mund të dëmtohen duke përfshirë dhe interesin publik. Andaj Paneli konsideron se ankesat e parashtruara nga OE “TSR SHPK” dhe ankesa e OE “G.S.G SHPK” duhen përfshirë sërish në procesin e rivlerësimit, kurse nuk ka bazë të mjaftueshme që në procesin e rivlerësimit të përfshihet po ashtu dhe ankesa e OE “Eric Utsch AG Horn & Co Kosova” ShPK dhe OE tjerë të eliminuar e të cilët janë pajtuar me këtë eliminim. Prandaj dhe vendosi si në kuptim të këtij Vendimi, duke i rekomanduar AK lidhur me sa vijon:

Obligohet AK, që në fazën e ri-vlerësimit të merrë parasysh rekomandimet dhe konstatimet e nxjerrura nga ana e Panelit nga ky vendim, Raportin e Agjencionit të Forenzikës për pikat të cilat nuk janë kontestuar nga ana e Panelit, Raportin e Fakultetit teknik për matjen e materialit bazë dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit. Mbi bazën e këtyre kërkesave, raporteve dhe konstatimeve të vendimeve të OSHP të nxjerrë vendim meritior lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Në përfundim të gjithë kësaj Paneli vendosi sikurse në dispozitivin e këtij, nisur nga bindja dhe gjykimi i pavarur i tij se ka aplikuar zgjidhje në duhur në këtë rast. Andaj nga të lartcekurat dhe duke ju referuar neni 98, 99 lidhur me nenin 104, 105 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv

të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTERIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - TSR SH.P.K., G.S.G SH.P.K., Horn & Co. Kosova SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: